



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më **21.05.2019** (martë) duke filluar ne ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raportimi i Komisionit për dhënjën e tokës Komunale në Shfrytëzim;
3. Shqyrtimi i propozimit për dhënje afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;
4. Propozim Vendimi për Formimin e KKSB-së;
5. Draft Plani Aksional i Komunes për efqenc të energjisë (PAKEE);
6. Propozimi për percaktimin e automjetve të vjetra Komunale që janë jashtë përdorimit;
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:15.05.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 15.04.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhui, Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Arsimit Tomislav Stankovic, ZBPZHR Avdi Vllasaliu dhe perfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raporti financiar për tremujorin e parë Janar – Mars 2019;
3. Shqyrtimi i propozimit për dhënje afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës;
4. Shqyrtimi i propozimit të EccoHigienes, për pagesen e participimit për mirëmbajtje të ambientit me 1,6,8 Maj 2019;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me rend dite?

Nënkryetari i Komunës Sinisa Dimic pasi pershendeti të pranishmit tha: po e propozoj një pikë për rend dite bëhet fjalë për formimin e KKSBB-së, ky është vetem një propozim i vendimit për formimin e KKSBB, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: kush është për aprovimin e këtij propozimi për rend dite?

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të hyj në rend dite.

Drejtori i Shendetësisë Tomislav Stankovic pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe unë e kam një propozim është statuti i QKMF-së Kufcë të eperme dhe e propozoj që të votohet dhe të shkoj në Kuvend e në Kuvend do të diskutojm më gjerësishtë.

Kryesuesi tha: kush është për aprovimin e këtij propozimi për rend dite?

Aprovohet njëzëri kjo pikë që të hyj në rend dite.

Pasi nuk pati propozime tjera aprovohet njëzëri rendi i ditës me këto dy pika shtesë të propozuara:

1. Propozim vendimi për formimin e KKSBB-së dhe
2. Aprovimi i Statutit të QKMF-së Kufce e Eperme.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Raporti financiar për tremujorin e parë Janar – Mars 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën Drejtorit të Financave.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht ju kerkoj falje që nuk e keni marrë me kohë materialin por nuk kemi pasur mundësi që ta pregadisim më herët për arsye të kohës shumë të shkurtë, andaj ju lus që ta votoni të shkoj në Kuvend e më pastaj atje të diskutojmë. Në pika të shkurta po ju paraqes të hyrat gjatë këtij tremujori, të hyrat nga tatimi në pronë 10,530.26 €, të hyrat nga regjistrimi i automjeteve 3,040.00 €, Taksat Komunale për leje ndertimi 282.00 €, taksat komunale për regjistrimin e trashegimisë 110.00€, taksa për ndrrimin e destinacionit të tokës 15,439.00 €, taksa për qertifikatat e lindjes 565.00 €, taksa për qertifikatat e kurorëzimit 94.00€, taksat për qertifikatat e vdekjes 83.00€, taksat tjera administrative 511.00€, taksat për vertetime prej 1€ 304.00€, taksa tjera administrative-lista poseduese 4,005.00€, qiraja nga objektet publike 300.00€, qiraja nga prona publike 150.00€, të hyrat nga konfiskimi 278.40€, participimi nga shendetësia 10.00€, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: çdo herë raportet financiare po na vin para mbledhjes dhe nuk po kemi kohë mi analizu.

Sercan Todorovic tha: freebalanci nuk ka qenë i hapur dhe kjo ka qenë arsyaia që është vonuar pasi që nuk kemi pasur mundësi që ti marrim të dhënat.

Selatin Nuhiu tha: po e shoh një shpenzim prej mbi 18.000€ shpenzime të rrymes është një shumë e madhe.

Sercan Todorovic tha: ky shpenzim është për tre muaj si dhe janë disa shpenzime që nuk janë kryer në vitin e kaluar.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i propozimit për dhënie afatshkurtër të vendgjahishtës së Komunës së Novobërdës; Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën ZBPZHR Avdi Vllasaliut.

Avdi Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: ne kemi marrë një pelqim prej Ministrisë së Bujqësisë për dhënjën me qira të vengjuetis dhe na duhet edhe një vendim i Kuvendit, njëher duhet të formohet komisioni nga Kuvendi dhe nga Drejtoritë dhe të ipet pelqimi që të shkoj në menaxhim nga gjuetia, ne e kemi vetem për vendgjuetin e Kalas pelqimin e Shoqates Kalaja. Kur të formohet komisioni do ti vendos kriteret për dhenje ne menaxhim.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: po nderlidhem me formimin e komisionit pasi që ka shumë komisione që janë formuar në Kuvend por asgjë nuk kanë punuar.

Selatin Nuhiu tha: e falenderoj zyrtarin e bujqësisë por kisha pasur dëshirë që ta shoh këtu Drejtorin e Bujqësisë, pasi që në nuk e dim se kush është Drejtor, propozoj që kjo pikë të shkoj në Kuvend por më duket shumë që të ipet 10 vite është shumë të mirret në menxhim kishte qenë më mirë për 1 apo 2 vite.

Avdi Vllasaliu tha: 1 vit është pakë pasi që ne perseri duhet pas një viti të mirremi me këtë qështje perseri, shumica e Komunave e kanë dhënë për 10 vite, kriteret vendosen nga komisioni por së pari shoqata duhet të jetë e licencuar, numri i biznesit, kopja e leternjoftimit, deshmia e tatimit në ATK, pasyra e të hyrave vjetore, çmimi ofertues etj.

Kryesuesi pyeti se ka ndonjë udhëzim që e percaktonë formimin e komisionit?

Avdi Vllasaliu tha: po duhet të ketë ose duhet të bazohemi në ligjin që Komunitat tjera i kanë dhënë në menaxhim.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: po e pyes zyrtarin e bujqësisë a keni dhënë më heret dhe të shkojm në bazë të atyre procesdurave, gjithashtu shpresoj se ky komision do të punoj e jo si ato komisionet e më hershme.

Avdi Vllasaliu tha: për herë të parë jemi duke e dhënë këtë vendgjueti, i kemi marrë disa të dhëna në Komuna tjera, ne së pari kemi derguar një shkresë në Ministri të Bujqësisë dhe e kemi marr pelqimin.

Kryesuesi tha: ne e kemi pasur pikë shqyrtimi i propozimit për dhenje në shfrytëzim ndërsa po bëhet fjale për formim të komisionit.

Avdi Vllasaliu tha: po vendimi për komisionin për dhënje në shfrytëzim të vendgjuetis, komisioni i vendos kriteret.

Selatin Nuhiu tha: duhet të jetë ligji dhe të shikohet se në bazë të cilit ligj.

Kryesuesi tha: sa i perket ligjit duhet duhet të egzistoj udhëzimi administrativ për formimin e komisionit dhe përbërjen e antarëve.

Avdi Vllasaliu tha: duhet të egzistoj, Komuna e gjilanit në komision i kish të kyçur edhe përfaqësuesit e fshatrave.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri nga anatrët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërtë: Shqyrtimi i propozimit të EccoHigienes, për pagesen e participimit për mirëmbajtje të ambientit me 1,6,8 Maj 2019;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Menaxherit të EccHigienes Naser Ibrahimit.

Naser Ibrahimit pasi pershendeti të pranishmit tha: siç e dini edhe ju është ndarë një vendim i Kuvendit në vitin 2009, që në regjionin e Stanishorit me datë 1 Maj dhe te kalaja me 6,8 Maj, ne gjithmon e kemi marrë nga një pelqim prej Kuvendit Komunal për arsye se kemi pasur probleme në të kaluaren pasi që mjetet që janë grumbulluar kemi pasur për obligim që ti paguajm puntorët, mirëpo që 4 vite ne mjetet që i grumbullojmë prej nga 1€ për çdo makin që hyn i dorzojm në arkë dhe aty paguhet edhe tatimi dhe nuk kemi problem me ATK andaj kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të shkoj në Kuvend në mënyr që në të dalim gjatë këtyre ditëve që ti inkasojm nga 1€ dhe me këto mjete që grumbullohen ne do ti pastrojm mbeturinat e grumbulluara gjatë këtyre ditëve.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: e pershendes punën e EccoHigienes që e bënë një punë shumë të mirë, nuk kam asnjëher vërejtje, por kjo pages prej 1€ është ngarkesë për qytetarin pasi që kanë festë dhe dalin për të festuar por ato mbeturina të cilat mbesin duhet ti largoj dikush, dhe nese ka mjete që grumbullohen e teproj kishte qenë mirë që të kthehen në investim si në mirëmirëmbajtje të kamionëve.

Xhejlane Behluli tha: po nderlidhem me pagesen e qytetarëve prej 1€, pasi që sikur të kishin pas kulturë të gjithë qytetarët për me mbledh mbeturinat e veta dhe nuk kishte pasur nevoj enkasim të mjeteve por vetem nga një qese për mbeturina me ju dhënë qytetarëve por fatkeqësisht mungon kultura dhe duhet të paguhet ajo shuma pasi që duhet të paguhen ata që e pastrojnë në fund ambientin, kështu që e pershends punën e tyre dhe ne do ti perkrahim ashtu si i kemi perkrah edhe vitin e kaluar.

Naser Ibrahimit tha: ne i kemi paisur të gjitha veturat me qese por askush nuk i ka hudhur aty mbeturinat, ne te gjitha ato mjete qe i mbledhim rreth 1600€, mirëpo ne duhet të dalim për çdo ditë deri sa të bëhet pastrimi edhe ai punëtori e ka ditë festë pushim por duhet të punojnë dhe 20€ është për çdo punëtorë që del atë ditë, ndërsa në duhet afer pesë ditë të dalim pa nderpre për çdo ditë, nese tprojn mjete padyshim që i investojm aty ku kemi nevoj.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e pestë: Propozim vendimi për formimin e KKSBB-së;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Nenkryetarit të Komunës Sinisa Dimic.

Sinisa Dimic tha: në bazë të udhëzimit administrativ duhet që të formohet KKSBB-ja dhe mendoj se tash janë plothësuar kushtete për formimin e KKSBB pasi që më heret kemi pasur disa probleme, ky Komitet është shumë i rendesishëm për shumë arsye, më shumë për arsye të sigurisë pasi që në Komunën tonë ka pasur shumë raste të vjedhjeve, në mandatet e kaluara KKSBB-ja nuk ka dhënë rezultate të mjaftueshme, para jush e keni propozimin dhe ne mundë të diskutojm perseri në Kuvend lidhur me emrat dhe qështjet e tjera, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: më intereson të di se si janë zgjedhur këta emra dhe a do të paguhen këta persona?, nese po, sa paguhen?, pasi që sa kam informata KKSBB-ja e mandatit të kaluar nuk është paguar të gjithë.

Sinisa Dimic tha: emrat janë të zgjedhur në bazë të udhëzimit adiministrativ i cili e cakton se kush duhet me qenë antarë i këtij komiteti, antarët qe janë të punësuar në instucione nuk janë paguar ndërsa të tjeret janë paguara, por nuk e di se sa janë paguar pasi nuk kam qenë shfrytëzues i asaj meditje.

Milica Jovanovic tha: e kam një pyetje se a duhet të jetë ndonjë antarë i Kuvendit pjesë e KKSBB-ës.

Sinisa Dimic tha: udhëzimi administrativ nuk e ka parapa që antarët e Kunedit të jenë në KKSB.
Selatin Nuhiu tha: po e pyes Nenkryetarin pasi atë list të cilën e prezantoj unë nuk e kam dhe nese ka mundësi me na tregu se kush e ka bërë këtë list dhe kush i ka zgjedh këta emra pasi që Nenkryetarët e Komunës nuk kanë të drejt të jenë në KKSB pasi që ligji e percakton se kush duhet të jetë antarë i këtij komiteti dhe ajo listë duhet të bëhet në bashkpunim me ne.

Sinisa Dimic tha: ky është vetem propozim nga zyra e Kryetarit, dhe këta antarë janë zgjedhur në bazë të udhëzimit administrativ.

Xhejlane Behluli tha: lista e antarëve të KKSB është derguar në mbledhjen e kaluar dhe unë e kamë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e gjashtë: Aprovimi i Statutit të QKMF-së Kufce e Eperme;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Shendetësisë Tomislav Stankovic;

Tomislav Stankovic tha: para jush e keni statutin i cili është pregdatur në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative në fuqi, Komuna ka të drejt të formoj QKMF në bazë të numrit të banorëve në bazë të nenit 6 pika 3 sipas standardeve që janë të shenuar prej Ministrisë së Shendetësisë. E gjitha kjo është si ide për furnizimi me material mjeksorë dhe barna për QKMF pasi që në QKMF në Novobërde po kemi probleme me furnizim me material. Ky statut është vetem propozim e ju keni të drejt të pyesni në lidhje me këtë, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: mirë që ka ardh si ide pasi që është në të mirë të qytetarëve, e permendi Drejtori në fillim se kemi problem me furnizim me material nese ne e bëjm edhe një qender tjetër perseri po rritet edhe më shumë nevoja e furnizimit me material. Tjetra është se gjatë degjimit publik buxhetor e kam kerkuar një qender në Pasjak është arsye se e kemi afer Gjilanin, dhe një qështje që më intereson të di është se a është caktuar vendi dhe objekti?.

Tomislav Stankovic tha: sa i perket asaj se Komuna e Gjilanit është afer nuk ak lidhje pasi që ne jemi Komunë e ndarë, unë kam biseduar edhe me zv.Ministrin e Shendetësisë ajo më e rendesishmja është se këtë statut duhet ta aprovoj Kuvendi Komunal dhe ne më von e dergojmë në Ministri dhe Ministria vendos për hapjen e kësaj QKMF. E kemi zgjedhur Kufcen e eperme për arsye të numrit të banorëve, dhe e kemi objektin.

Selatin Nuhiu tha: e kam një pyetje, në bazë të këtij statuti a parashihet të rritet numri i puntorëve, ne në fshatin Llabjan nuk kemi doktor familjar dhe e kisha pyte Drejtorin se a ka mundësi me punësu një doktor?. Si dhe një pyetje e kam për higjen se si qendron situata në Komunën e Novobërdës?, pasi që siç e di kan munges të materialit higjenik.

Tomislav Stankovic tha: e kemi prur një vendim që Dotori i QKMF Novoberde 3 here në jav të punoj në Llabjan dhe më shumë nuk ka mundësi pasi që punon edhe në Novobërdë, në bazë të këtij statuti kam kerkuar që të rritet numri i doktorëve, sa i perket materilaht higjenik keni të drejt, unë e kam bërë kërkesen furnizimit që urgjentisht të bëhet furnizimi me material higjenik.

Selatin Nuhiu tha: ju duhet të kerkoni në Ministri që të rritet numri i mjekve, se dhe të ketë sherbim mjeksorë edhe gjatë nate.

Kryesuesi tha: sa mjek janë të punësuar në Komunën tonë?.

Tomislav Stankovic tha: 3 doktor, 1 stamatolog.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e shtatë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovnaovic tha: janë tre Drejtor që janë në list andaj kishte qenë mirë që të jenë prezent në mbledhjen e ardhshme që ti shohim se kush janë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.


Procesëmbajtëse

Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E BUJQËSIS PYLLTARIS DHE ZHVILLIMIT RURAL
DIREKTORAT POLJOPREVREDE SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA

1.Ligji Nr.02/L-53 për Gjuetinë (GZ.Nr.08,dt. 01.01.2017)dhe nenit 8 paragrafi 8.1,8.4,8.5, i

Udhëzimit Administrativ NR.10/2007

Kriteret e caktimit të zonave dhe procedurave për themelimin e vendgjuetive dt,14.09.2007

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË VENDGJUETIVE SË

KOMUNËS SË NOVOBËRDËS

Për Kuvendin Komunal: PIKA E RENDIT

1.Shqyrtimi i propozimit për dhënen në shfrytëzim afatshkurtër të vendgjuetive të komunës,
dhënen e pelqimit nga Kuvendi Komunal Novobërdë

Data: 08.05..2019

Zyrtari i DBPZHR

z.Avdi Vllasaliu